

**MIRATOHET
SOTIRAQ FILO****KRYETAR I BASHKISE****Plani strategjik 2024 – 2026*****“Për veprimtarinë e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Korçë”*****• Qëllimi i planit strategjik dhe misioni i NJAB****- Qëllimi i Planit Strategjik**

Plani strategjik 2024-2026 “Për veprimtarinë e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Korçë, ka si qëllim identifikimin e fushave të veprimit të strukturës së auditimit të brendshëm të bashkisë Korçë, për periudhën 3 vjeçare.

Ai bazohet në analizën e risqeve të programeve dhe veprimtarive të identifikuara për auditim dhe përcakton mbulimin/frekuencën e auditimit sipas subjekteve që programohen për audit.

Plani strategjik 2024-2026 i veprimtarisë së anagazhimeve të auditimit të brendshëm është bazuar në dokumentin e vlerësimit të riskut, të hartuar një herë në vit, ka marrë në konsideratë informacionet nga menaxhimi i lartë e bordi i drejtorëve, ndryshimet e strukturës buxhetore sipas programeve, gjetjet e evidentura nga DHAB në MFE për planifikimin e vitit të mëparshëm si dhe rekomandimet e KLSH-së për njësinë e AB të bashkisë Korçë.

Gjatë hartimit të planit strategjik 2024-2026 janë marrë parasysh angazhimet e pranuar dhe plani është bazuar në mundësinë e angazhimit për të përmirësuar procesin e qeverisjes, menaxhimin e risqeve, shtimin e vlerës dhe përmirësimin e veprimtarive të Bashkisë.

Plani strategjik 2024-2026 “Për veprimtarinë e Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Korçë” është një element i kontrollit për tu siguruar që të gjitha veprimtaritë, programet dhe operacionet e bashkisë/subjekteve në vartësi të saj, mbulohen nga funksioni i AB.

Ky plan është dokumenti që vërteton zbatimin e komponentit të monitorimit dhe vlerësimit të sistemit të MFK-së të bashkisë Korçë nga auditimi brendshëm.

Funksioni i auditimit të brendshëm, është konsultuar dhe ka rënë dakort me manaxhimin lidhur me problemet e kontrolleve të brendshme dhe administrimit, ka synuar që të zbatohet në mënyrë efektive mbulimin e veprimtarive kryesore dhe me risk më të lartë.

Angazhimet e auditimit të brendshëm në planin strategjik janë vlerësuar mbi bazën e nevojave 3 vjeçare për auditime. Vlerësimi i nevojave të auditimit do të rishikohet çdo vit, në kohën kur do të hartohet plani vjetor i auditimit për vitin e ardhshëm, duke siguruar që janë përfshirë të gjitha veprimtaritë e reja dhe ndryshimet e tjera të programeve.

Frekuenca e auditimit është përcaktuar nga drejtore e auditimit të brendshëm të bashkisë Korçë, duke u bazuar në shkallën e riskut që shoqëron funksionin e auditimit gjatë implementimit të tij dhe në disa raste në gjykimin e drejtimit.

- Misioni i NJAB.

Auditimi i brendshëm në ushtrimin e veprimtarisë së tij të pavarur dhe objektiv, synon të ndihmojë subjektet e audituara të Bashkisë Korçë, të përmbushin objektivat e tyre. Ai bën vlerësime, jep opinione dhe rekomandime objektive :

- për identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut
- për funksionimin dhe mjaftueshmërinë e sistemeve
- për përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve të kontrolleve
- për përputhjen e veprimtarisë së njësisë me kuadrin rregullator
- për funksionimin e elementeve të kontrollit të brendshëm (ambjentin e kontrollit, menaxhimin e riskut, aktivitetet e kontrollit, informimi, komunikimi dhe monitorimi)
- për ruajtjen e aseteve
- për besueshmërinë dhe gjithëpërfshirjen e informacionit financiar dhe operacional
- për të siguruar titullarin e subjektit të audituar se fondet publike janë përdorur me ekonomi, efikasitet, efikasitet, sipas planifikimit dhe qëllimit të miratimit në buxhetin e bashkisë

- për përmbushjen e detyrave dhe arritjen e qëllimeve të njësisë.

Auditimi i brendshëm ndihmon menaxhimin duke ofruar analiza, rekomandime, këshilla dhe informacion lidhur me veprimtaritë që ka vlerësuar. Duke asistuar të gjitha nivelet e menaxhimit në kryerjen efektive të përgjegjësiave të tyre, i jep menaxhimit të lartë vlerësime të operacioneve e veprimeve, këshillime të pavarura, konfidenciale, për përdorimin me fektivitet, efikasitet, ekonomi të burimeve.

• **Organizimi i NJAB dhe kuadri ligjor.**

- *Organizimi i NJAB*

Struktura e AB në bashkinë Korçë është drejtori. Sipas Urdhërit të kryetarit të bashkisë, struktura është miratuar me 1 drejtor dhe me 3 audite, por në fakt të punësuar, për vitin 2023 janë 1 drejtor dhe 2 audite.

Puna brënda strukturës është organizuar pa përgjegjës grupi, auditimet për vitin 2023 janë kryer nga të 2 auditet dhe drejtori i drejtorisë. Përveç punës si pjesë e grupit, drejtori ka monitoruar punën e grupit dhe në veçanti punën e auditueses së paçertifikuar dhe ka bërë vlerësimin e cilësisë.

Varësia e njësisë së AB është nga kryetari i bashkisë.

- *Kuadri ligjor*

Struktura e AB është organizuar dhe funksionon në zbatim të

- ✓ Ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”
- ✓ Manualit të AB, miratuar me Urdhërin nr.100, datë 25.10.2016 të Ministrit të Financave, ndryshuar me Urdhërin nr.4, dt.10.01.2020 të Ministres së Financave “Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në Manualin e AB, miratuar me urdhërin nr.100, dt.25.10.2016”.
- ✓ Standarteve ndërkombëtare për praktikën profesionale të AB, publikuar me urdhërin nr.40, datë 08.05.2017 të Ministrit të Financave.
- ✓ Udhëzimi nr.42, dt.27.10.2020 i Ministrit të MFE “Mbi ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të dhëna nga auditimi i brendshëm në sektorin publik”.
- ✓ Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.
- ✓ Ligjit nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.
- ✓ Ligjit nr.152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”.
- ✓ Ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSh”.
- ✓ Ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, me ndryshimet përkatëse.
- ✓ Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSh”.
- ✓ Ligjit nr.10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, me ndryshimet përkatëse.
- ✓ Ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, me ndryshimet përkatëse.
- ✓ Ligjit nr.9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.
- ✓ Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.
- ✓ Ligjit nr.9780, datë 16.07.2007 “Për inspektoriatin e ndërtimit”.
- ✓ Ligjit nr.8756, datë 26.03.2002 “Për emergjencat civile”.
- ✓ Ligjit nr.7961, datë 12.07.1995 Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë, me ndryshime.
- ✓ Ligjit nr.10160, datë 15.10.2009 “Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit publikë”.
- ✓ Ligjit nr.8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë së bashkisë dhe komunave”, me ndryshimet përkatëse.
- ✓ Ligjit nr.9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, me ndryshimet përkatëse.
- ✓ Ligjit nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”.
- ✓ Ligjit nr.7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”.
- ✓ Ligjit nr.7870, datë 13.10.1994 “Për sigurimet shëndetsore në RSh”, me ndryshimet përkatëse.
- ✓ Ligjit nr.9136, datë 11.09.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetsore në Republikën e Shqipërisë”, me ndryshimet përkatëse.
- ✓ Ligjit nr.9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” dhe rregulloren e nxjerrë për zbatimin e tij.
- ✓ Të gjitha aktet ligjore e nënligjore të dala në zbatim të ligjeve të mësipërme.
- ✓ Rregullorja e Bashkisë Korçë e miratuar me VKBashkiak për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë Korçë, si dhe të gjitha rregulloret e ndërmarrjeve dhe institucioneve të vartësisë.

• Objektivat strategjike.

Objektivi strategjik i AB është, të nxisë politikat e qeverisjes së mirë, përmirësimin dhe forcimin e sistemeve të KB në të gjitha subjektet e audituara. Të detajuara objektivat janë :

1. Dhënia e sigurisë objektive, që risqet janë identifikuar dhe vlerësohen e menaxhohen nga strukturat përgjegjëse.
2. Dhënia e sigurisë së arsyeshme se sistemet e kontrollit janë vendosur, funksionojnë me efektivitet dhe në shkallë të përshatshme brënda subjekteve të audituara.
3. Dhënia e sigurisë së pavarur dhe objektive, dhënia e këshillimeve të cilat shtojnë vlerën, përmirësojnë operacionet dhe ndihmojnë subjektet e audituara të arrijnë objektivat.
4. Planifikimi dhe kryerja e auditimeve të kombinuara (sistemi i pajtueshmërisë dhe financiar) dhe auditimeve të performancës.
5. Kryerjen e auditimeve sipas kërkesave të menaxhimit.
6. Forcimin konceptit të auditimit të brendshëm si funksion i pavarur, si mbështetje për menaxhimin për realizimin me sukses të detyrave të tij.

• Identifikimi i subjekteve.

Për periudhën 2024-2026 janë identifikuar 11 subjekte auditimi si vijon :

Bashkia Korçë, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike, Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhe, Qendra e Artit e Kulturës (Biblioteka, Teatri, Qendra kulturore), Klubi Shumësportësh "Skënderbeu", shoqëria "Qendra Sportive Korçë" sh.a., shoqëria "Tregu i Shitjes me Shumicë fruta-perime" sh.a, shoqëria „Korca 2008” sh.a, Qendra Ditore e Riaftësimit, Qendra Rezidenciale e Zhvillimit të Antikapatëve, Shtëpia e Foshnjës, këto tre të fundit vetëm për fondet e akorduara nga Bashkia.

• Identifikimi i fushave/sistemeve prioritare.

Sipas subjekteve janë identifikuar fushat si vijon :

Bashkia sipas Fushave : Të ardhurat, Kontroll Territori, Prokurimet, Policia Bashkiake, Mbrojtja nga zjarri e shpëtimi, Projektet e turizmit, IT-së, migracionit dhe diasporës, Sektori i integritetit europian, Planifikimi dhe kontrolli i zhvillimit të territorit, Shërbimi Urban, Shërbimi i Pastrimit, Shërbimi i varrezave, Shërbimi i kujdesit Social, Financa, Drejtoria Juridike, Burimet Njerëzore, protokoll arkiva dhe shërbimet mbështetëse, Shërbimi i informimit qytetar, Inspektoriati i Mbrojtjes së territorit, Shërbimet në njësitë administrative Bulgarec, Drenovë, Mollaj, Voskopojë, Voskop, Vithkuq dhe Lekas, Shërbimet në rajonet nr.1, nr.2, nr.3, Shërbimet në sektorin e bujqësisë e të pyjeve, Strehimi social dhe menaxhimi i banesave sociale.

Nd.& Instituc. Vartësi : Ndërmarrja e Shërbimeve Publike (Gjelbërimi, Rrugët rurale, Bordi i kullimit), Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit & Çerdhe, Qendra e Artit e Kulturës (Biblioteka, Teatri, Qendra kulturore), Klubi Shumësportësh, Qendra Ditore e Riaftësimit, Qendra Rezidenciale e Zhvillimit të Antikapatëve, Shtëpia e Foshnjës (tre të fundit vetëm për fondet e financuara nga bashkia).

Shoqëri anonime : Qendra Sportive Korçë sh.a, Tregu i Shitjes me Shumicë sh.a, Korça 2008 sh.a

• Identifikimi dhe vlerësimi i risqeve.

Gjithësej janë 11 subjekte për tu audituar (bashkia + 7 ndërmarrje e institucione vartësie + 3 shoqëri anonime). Brënda bashkisë janë identifikuar gjithësej 21 fusha për tu audituar, nga të cilat 9 fusha vlerësohen me risk të lartë dhe 12 fusha të tjera me risk të mesëm.

Për 7 ndërmarrjet dhe institucionet e vartësisë, 1 prej tyre është vlerësuar me risk të lartë, 5 institucione janë vlerësuar me risk të mesëm dhe 1 institucion me risk të ulët.

Për 3 shoqëritë anonime, 1 prej tyre është vlerësuar me risk të lartë dhe 2 është vlerësuar me risk të mesëm.

Në të tre vitet e planit strategjik janë parashikuar për tu audituar më parë institucionet dhe fushat me risk të lartë, duke mbajtur parasysh edhe ndryshimet strukturore të veprimtarisë së bashkisë.

Në vlerësimin e riskut jemi nisur nga rezultatet e auditimeve të mëparshme për subjektet e fushat e parashikuara për auditim. Ndërsa për subjektet e fushat e reja vlerësimi i riskut është bërë përgjithësisht në nivelin e lartë për shkak të njohjes së kufizuar të veprimtarisë së tyre.

Në planin strategjik 2024-2026 janë marrë parasysh, orientimet e DHAB-së në MFE, gjetjet e evidentura nga DHAB në MFE për planifikimin e vitit të mëparshëm si dhe rekomandimet e KLSH-së për drejtorinë e AB, duke parashikuar angazhime auditimi për fusha të ndjeshme si Detyrimet financiare të prapambetura, Zbatimi i rekomandimeve, projektet me fonde nga donatorë të huaj, Prokurimet, drejtoria Juridike, Inspektoriati i mbrojtjes së territorit, Shërbimet në njësitë administrative Bulgarec, Drenovë, Mollaj, Voskopojë, Voskop, Vithkuq dhe Lekas, Shërbimet në rajonet nr.1, nr.2, nr.3, Shërbimet në sektorin e bujqësisë dhe pyjeve, Strehimin social dhe menaxhimin e banesave sociale, Qendrën e artit dhe kulturës dhe Shoqërinë Korça 2008 sh.a.

Në hartimin e Planit Strategjik të AB kanë ndikuar faktorët e mëposhtëm :

<i>Rëndësia.</i>	Njësia e AB të shpenzojë më shumë kohë për fushat e reja dhe më me rëndësi për bashkinë.
<i>Materialiteti.</i>	Për fushat e mëdha të të ardhurave dhe shpenzimeve të harxhohet më shumë kohë auditimi.
<i>Ndryshimi.</i>	Kur një sistem apo fushë ka ndryshuar, risku rritet, prandaj AB të shikojë për këto ndryshime në vitin që janë bërë ndryshimet.
<i>Risku.</i>	Burimet e AB t'i kushtohen fushave ku risku është më i lartë.
<i>Pikpamjet e menaxhimit.</i>	AB të marrë në konsideratë shqetësimet e menaxherëve.
<i>Frekuenca.</i>	Frekuencë më e shpeshtë tek subjektet me risk më të lartë.
<i>Ndikimi i jashtëm.</i>	Monitorimi i strukturës së AB.

• **Kufizimet e auditimit.**

- Vlerësimi i auditimit si njësi inspektimi, nga titullarët e subjekteve e fushave të parashikuara për auditim.
- Ndryshimet e planit të parashikuar për shkak të kërkesave të titullarit për projekte apo detyra të posaçme.
- Mungesa e bashkëpunimit reciprok dhe përgjegjshmëria e subjekteve që auditohen.
- Mungesa e identifikimit dhe vlerësimit të risqeve nga vetë subjektet që auditohen.
- Mungesa e veprimtarive të kontrollit të brendshëm të vendosuar nga vetë subjektet që auditohen.
- Mungesa e plotësimit të strukturës me personelin e nevojshem.

• **Prioritete.**

- Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve të dhëna.
- Monitorimi i strukturës së AB, sigurimi i cilësisë së auditimit.
- Monitorimi i sistemit të raportimit të të dhënave për veprimtarinë e AB.
- Zhvillimi i veprimtarisë së AB në pajtueshmëri me Kartën e AB dhe dispozitat ligjore.
- Marrja parasysh e rekomandimeve të adresuara nga auditimi i Bashkimit Europian, korrik 2019.
- Ofrimi i sigurisë së tillë që veprimtaria e AB të konsiderohet nga strukturat e larta drejtuese, si shtim vlere dhe përmirësim i aktivitetit të subjekteve.

Bashkangjitur me Planin Strategjik janë anekset si më poshtë :

• **Anekset e Planit Strategjik**

- *Pasqyra 1 Vlerësimi i nivelit të riskut për subjektet (sipas Manualit të AB, kapitulli III)*
- *Pasqyra 2 Plani strategjik i subjekteve të synuara për tu audituar në vitet 2024-2026 (sipas Manualit të AB, kapitulli III)*

DREJTORIA E AUDITIMIT TE BRENDSEHEM BASHKIA KORÇË

Drejtores

Athinulla TREBICKA